



Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), po vazhdon zbatimin e projektit **“Fuqizimi i lëndës së Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve në ofrimin e shërbimit ligjor për shtresat në nevojë”** mbështetur nga Programi i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST).

Duke synuar forcimin e mëtjshëm të Klinikës së Ligjit dhe rrjedhimisht, të grupeve në nevojë, përmes ofrimit të shërbimit ligjor, rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve të Klinikës në dhënien e ndihmës ligjore falas, për shtresat në nevojë, janë realizuar deri disa veprimtari dhe aktivitete, të cilat paraqiten përmbledhtazi, më poshtë:



- **Ofrimi i shërbimit ligjor falas për grupet në nevojë, në mënyrë të veçantë për viktimat e dhunës me bazë gjinore.** Studentët kanë informuar, këshilluar dhe kanë përgatitur opinione ligjore për rastet konkrete që i janë referuar Klinikës së Ligjit nga Qendra për Nisma

Ligjore Qytetare. Për informimin, këshillimin dhe përgatitjen e opinioneve ligjore ata kanë punuar nën mbikëqyrjen e Avokateve të QNL-së dhe pedagogut përkatës të lëndës. Përmes këtij angazhimi të drejtpërdrejtë të studentëve është mundësuar forcimi i njohurive dhe aftësive praktike.



- **Organizimi i trajnimeve me studentët e Klinikës së Ligjit.** Këto trajnime kanë kontribuar në rritjen dhe forcimin e aftësive të studentëve të Klinikës së Ligjit. Për këtë qëllim janë organizuar dy trajnime 2-ditore me temë: "Strengthening of practical skills of the students of Legal Clinic." Prezantimet e mbajtura nga Prof.As.Dr. Evis Alimehmeti, Prof.As.Dr.Orjona Muçollari, Prof. Alban Koçi dhe Avokatet e QNL-së,

trajtuari njohuri teorike dhe praktike të temave përkatëse. Gjithashtu pjesë e rëndësishme e këtyre trajnimeve ishin edhe diskutimet interaktive, të cilat i ndihmuan studentët e klinikës së ligjit që të pasqyronin problematikat e hasura gjatë shërbimit që ata ofrojnë në klinikë.



- **Organizimi i bisedave të ndryshme me studentë të Fakultetit të Drejtësisë mbi Klinikën e Ligjit dhe aktivizimi i tyre në veprimtaritë e Klinikës.** Organizimi i këtyre bisedave ka për qëllim që të promovojë veprimtaritë që zhvillohen në kuadër të këtij projekti, me qëllim rritjen e informimit mbi lëndën e Klinikës së Ligjit dhe të aktivitetit të saj, si dhe aktivizimit studentor në të. Në këtë kuptim janë organizuar disa takime informuese jo vetëm me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, po edhe me institucione të tilla si: Gjykata e Apelit, Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj. Ajo çfarë vlen të përmendet është fakti se të gjithë studentët që kanë marrë pjesë në këto biseda informuese kanë shprehur interes në lidhje me aktivitetin e Klinikës së Ligjit dhe mundësitë për t'u angazhuar pranë saj.



- **Organizimi i një debati imitues nga studentët e Klinikës së Ligjit, bazuar në bisedën mes dy Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të SHBA.** Ky “debat imitues” i bashkëbisedimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Antonin Scalia dhe Stephen Breyer, mbi mbështetjen në ligjin e huaj në gjykimet kushtetuese të kësaj gjykate erdhi i interpretuar nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë me rastin e 10 Majit, Ditës Shqiptare të Drejtësisë, në ambientet e Klinikës së Ligjit, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.